



STATUTI I SHOQATËS SË KONTABILISTËVE TË ÇERTIFIKUAR DHE AUDITORËVE TË KOSOVËS

Përmbajtja

Pjesa 1 – Definicionet

Pjesa 2 – Shoqata

Emri, anëtarët themelues dhe data e regjistrimit
Adresa e regjistruar e Shoqatës
Vula e Shoqatës
Statusi ligjor i Shoqatës
Përfaqësimi i Shoqatës
Komunikimi elektronik
Territori i aktiviteteve të Shoqatës

Pjesa 3 – Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës

Pjesa 4 – Anëtarët

Llojet e anëtarësisë

Anëtarët
Anëtarët studentë
Anëtarë e nderit

Pagesat e anëtarësisë
Diskualifikimi nga anëtarësia
Suspendimi nga anëtarësia

Pjesa 5 – Struktura organizative e Shoqatës

Asambleja e anëtarëve

Të drejtat dhe përgjegjësitë
Mbledhjet e përgjithshme
Mbledhjet e jashtëzakonshme
Agjendat dhe çështjet e posaçme
Procedura e votimit dhe kuorumi

Këshilli

Të drejtat dhe përgjegjësitë
Përbërja e Këshillit
Kriteret diskualifikuese
Kryetari
Nënkryetari
Arkëtari
Mbledhjet
Votimi në mbledhjet e Këshillit
Komisionet e Këshillit
Kompensimi i anëtarëve të Këshillit

Zyra Ekzekutive

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komisioni për Nominime

Pjesa 6 – Procedura disiplinore

Procesi disiplinor
Përbërja e Komisionit Disiplinor
E drejta në ankesë

Pjesa 7 – Rregullat e mirësjelljes profesionale

Pjesa 8 – Pasuritë

Pjesa 9 – Shpërbërja e Shoqatës dhe shpërndarja e pronës

Pjesa 10 – Hyrja në fuqi

Ky Statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse, Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, të themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut No. 1999/22 dhe e azhurnuar në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-134 mbi Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

Pjesa 1

Definicionet

Ligji i Aplikueshëm – i referohet dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligjit Nr.03/L-134 mbi Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe ligjeve tjera të tilla të shpallura nga Kuvendi i Kosovës.

ShKÇAK/Shoqata – Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

FNK – Federata Ndërkombëtare e Kontabilitetit

Kodi Etik – i referohet Kodit Profesional Etik të FNK

Anëtarët – Anëtarët e Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar të Auditorëve të Kosovës

Mandati i lejuar – i referohet zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit për jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme nga dy vite, nëse me Vendim të posaçëm të Këshillit dhe të miratuar nga Asambleja nuk parashihet ndryshe

DOA të **FNK** – Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit

UNMIK – Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Fjalët e cilësdo gjini të përdorura në këtë Statut do të nënkuptojnë edhe gjininë tjetër dhe fjalët e përdorura në njëjës do të nënkuptojnë edhe shumësin dhe shumësi do të nënkuptojë edhe njëjësin, aty ku është e aplikueshme.

Nëse çfarëdo dispozite e këtij Statuti apo interpretimet e mëparshme në Statut janë në konflikt me obligimet e theksuara ose të nënkuptuara nga DOA, do të mbizotërojnë kërkesat sipas DOA.

Pjesa 2

SHOQATA

Emri, anëtarët themelues dhe data e regjistrimit

2.1 Shoqata u regjistrua me 16 Maj 2001, me emërtimin "Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës". Anëtarët themelues të Shoqatës janë:

Jan Tyl, Voskovcova 1657, Cernosice 252 28, Czech Rep.

Lekë Musa, Ulpiana A/3 H-3 No.10, Prishtinë

Shukri Gashi, "Dukagjini" 6, Mitrovica

Bujar Sokoli, "Arbedin Terbeshi"- Arbëria, No.1, Prishtinë

Mustafe Ibrahimimi, "Bregu i Diellit" Rr. III, Lam. 11, Ban.14, Prishtinë

Lindita Shala, 3288 Reservoir Oval E Apt#504, Bronx, NY 10467 USA
Gina Kuta, 104 Eilson Street, Prishtinë
Bashkim Uka, Metohia Street No.8, Prishtinë

Tomorr Zhaveli, "Fan Noli" Arbëria, no. 23, Prishtinë
Faton Zeqiri, Rr "TMK"- Qafa, Lam. "C", Ban. 18, Prishtinë
Avni Jashari, Rr. "Sharrit" No. 10/a, Prishtinë
Gëzim Pirana, Rr. Adriatiku No.12, Prizren
Eugen Nuri, "Fehmi Agani"- Arbëria No.1, Prishtinë

Adresa e regjistruar

2.2 Zyra e regjistruar e Shoqatës është në adresën, Rr. Sylejman Vokshi nr.14, Prishtinë.

Vula e Shoqatës

2.3 Vula e Shoqatës do të ketë formë të rrumbullaket, me diametër përafërsisht 4.5 cm, dhe do të ketë të gdhendur emërtimin Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (apo akronimin e saj) në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze

Statusi ligjor

2.4 Shoqata është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit të aplikueshëm.

2.5 Shoqata është person i pavarur juridik i cili mund të paditet dhe të padis në emër të vet. Adresa e regjistruar e Shoqatës është edhe adresa e dorëzimit të dokumenteve ligjore. Shoqata do t'i pranoj dokumentet ligjore përmes postës elektronike vetëm kur janë të vërtetuara nga gjyqi kompetent.

2.6 Shoqata do të përkrahet financiarisht nga donacionet në para të gatshme, grante, anëtarësi dhe kontribute tjera të parapara me dispozitat e Ligjit të Aplikueshëm. Shoqata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saj jofitimprurëse në pajtim me dispozitat relevante të ligjit të aplikueshëm.

Përfaqësimi i Shoqatës

2.7 Shoqata do të përfaqësohet nga Kryetari dhe/ose Drejtori Ekzekutiv, duke u bazuar në kompetencat e tyre.

Në mungesë të Kryetarit, përfaqësues i Shoqatës do të jetë Nënkryetari, dhe në mungesë të Drejtorit Ekzekutiv i deleguari nga Zyra Ekzekutive.

Komunikimi elektronik

- 2.8 Të gjitha referencat në Statut lidhur me shpalljet ose komunikimet me shkrim do të përfshijnë komunikimet elektronike, përfshirë edhe e-mailin, faksin, shpalljet në ueb faqen e Shoqatës dhe mjetet e tjera të aprovuara nga ana e Këshillit.
- 2.9 Një dokument mund të nënshkruhet në formë elektronike ose në formë holografike dhe të komunikohet në formë elektronike.

Territori

- 2.10 Shoqata do ushtrojë aktivitetin e saj në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- 2.11 Shoqata mund të formojë degët e saj në komuna të ndryshme të Republikës Kosovës

Pjesa 3

Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës

- 3.1 SHKÇAK synon të jetë shoqatë prijëse në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Evropën Juglindore;
- 3.2 Qëllimi i SHKÇAK është:
- (i) të avancojë interesin publik përmes arritjes dhe promovimit të standardeve më të larta profesionale si dhe ofrimin e ekselencës në lëmin e kontabilitetit, auditimit, qeverisjes dhe menaxhimit financiar në të gjithë sektorët ekonomik të Republikës së Kosovës;
 - (ii) të ofroj udhëheqje kompetente
 - (iii) të veproj si qendër e ekselencës në kontabilitet, auditim, qeverisje dhe menaxhim financiar në Republikën e Kosovës;
- 3.3 SHKÇAK përfaqëson profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, dhe i udhëzon anëtarët e saj në përputhje me Kodin Etik të FNK, rregullat dhe parimet e mirësjelljes për anëtarët e saj, por duke mos u kufizuar vetëm në to.
- 3.4 Ky Statut e obligon ShKÇAK për:
- (i) implementimin e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK),
 - (ii) pjesëmarrjen në Programin e FNK për Përputhshmëri të Organizatave Anëtare; dhe
 - (iii) arritjen e përputhshmërisë së plotë me detyrimet aktuale dhe ato të ardhshme të cilat janë krijuar nga FNK për anëtarët e saj.
- 3.5 SHKÇAK është anëtare dhe bashkëpunon me institucionet dhe shoqatat regjionale dhe ndërkombëtare profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, rregullatorët, standard-vënësit dhe organet përfaqësuese për kontabilist dhe auditorë.

Pjesa 4 **Anëtarësia**

Llojet e anëtarësisë

- 4.1 SHKÇAK do të ketë tri lloje të anëtarësisë:
- Anëtar,
 - Anëtar student ,dhe
 - Anëtar nderi

Anëtarët

- 4.2 Personi do të bëhet anëtar i ShKÇAK vetëm nëse i/e ka:
- (i) kaluar provimet.
 - (ii) përmbushur kërkesat e përvojës praktike të përcaktuara nga Këshilli apo ndonjë trup tjetër relevant rregullator dhe aprovuar nga Këshilli.
 - (iii) nënshkruar deklaratën e pajtueshmërisë me obligimet profesionale të anëtarësisë së SHKÇAK
 - (iv) paguar tarifat adekuate të anëtarësisë të përcaktuara nga Asambleja, dhe
 - (v) përmbushur çfarëdo kërkesë tjetër profesionale të caktuar nga Këshilli kohë pas kohe.
- 4.3 Aplikacioni për t'u bërë anëtar do të aprovohet nga ShKÇAK vetëm nëse të gjitha kushtet për anëtarësim janë përmbushur dhe aplikuesi nuk është i diskualifikuar për t'u bërë anëtar.

Anëtarët studentë

- 4.4 Anëtar student është:
- (i) individi i regjistruar në Shoqatë për të ndjekur programin certifikues dhe provimet për kontabilist të certifikuar në Kosovë; ose
 - (ii) individi i regjistruar në Shoqatë i cili e ka përfunduar me sukses nivelin për Teknik të Kontabilitetit të programit certifikues të ShKÇAK.
- 4.5 Këshilli mund të përcaktojë më udhëzim administrativ apo rregullore kriteret të cilat duhet t'i përmbush një person për tu bërë apo për të mbetur student i regjistruar, kriteret të cilat mund të përmbajnë kërkesa të ndryshme për nivele të ndryshme të studentëve dhe të cilat kriteret mund të përfshijnë kërkesën për pajtueshmërinë e studentit me Statutin, me të gjitha rregulloret dhe vendimet e lëshuara nga ShKÇAK.
- 4.6 Anëtarët studentë janë të obliguar të paguajnë tarifat vjetore për anëtarësim.
- 4.7 Anëtarët studentë nuk do të kenë të drejtë vote në Asamble.

Anëtarët e nderit

- 4.8 Anëtar i nderit i Shoqatës është ai individ i cili me punën e tij të shkëlqyeshme dhe të shquar i ka kontribuar Shoqatës në përmbushjen e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve.
- 4.9 Këshilli do të rekomandojë nominimin e individit apo individëve të cilët i plotësojnë kriteret për Anëtar nderi. Këto nominime do të aprovohen nga Asambleja.
- 4.10 Anëtarët e nderit nuk do të kenë të drejtë që të marrin pjesë aktivisht në punën e Shoqatës. Anëtarësimi i tyre do të jetë vetëm çështje prestigji dhe ata nuk do të jenë të obliguar të paguajnë anëtarësi.
- 4.11 Anëtarët themelues të cilët nuk i plotësojnë kriteret për anëtarësim do të konsiderohen Anëtar nderi të Shoqatës.

Pagesat për anëtarësim

- 4.12 Asambleja e Shoqatës do të vendosë në lidhje me strukturën e tarifës për anëtarësi, duke u bazuar në rekomandimet e Këshillit.
- 4.13 Pagesa për anëtarësi do të jetë vjetore.

Skualifikimi nga anëtarësimi

- 4.14 Asnjë anëtar nuk do të njihet si anëtar i Shoqatës, si dhe anëtari aktual do të largohet për këto arsye:
- (i) shturja e kapaciteteve të përgjithshme për të ndërmarrë transaksione ligjore
 - (ii) dënimi për vepër penale për të cilën parashihet dënimi me burgim
 - (ii) administrim ligjor, bankrotim apo likuidim i padashur nga gjyqi apo autoriteti kompetent e cilësdo firmë të poseduar apo kontrolluar direkt apo indirekt nga ky person apo anëtar, ose
 - (iv) duke rrezikuar materialisht interesat e Shoqatës përmes punës dhe veprimeve të kryera
- 4.15 Individit do t'i ndërpritet anëtarësimi në SHKÇAK në cilindo nga rastet në vijim:
- (i) Dorëheqja e paraqitur në formë të shkruar në SHKÇAK nga anëtarësimi;
 - (ii) Vendimi i Komisionit Disiplinor pas hetimeve si dhe vendimi final për largimin e anëtarit nga regjistri i anëtarësisë.
 - (iii) Dështimi në pagesën e obligimeve ndaj SHKÇAK, duke përfshirë pagesat vjetore të anëtarësisë. Kjo do të bëhet pas periudhës tremujore të dërgimit të njoftimit përfundimtar apo kërkesës për pagesë të bërë në SHKÇAK, apo pas gjashtë muajve në rastet kur Zyra Ekzekutive nuk ka pasur mundësi ta kontaktojë anëtarin;
 - (iv) Vdekja, pamundësia apo pensionimi i anëtarit;
 - (v) Pas vendimit të marrë nga takimi i jashtëzakonshëm i Këshillit, në rastet kur sjellja e anëtarit ka dëmton interesin publik dhe ka qenë arsye për përjashtim, siç mund të jetë dënimi për aktivitete serioze kriminale.

Suspendimi nga anëtarësia

- 4.16 Anëtarët e Shoqatës të hetuar nga ana e komisionit disiplinor për shkeljet të Kodit të Etikës Profesionale apo rregulloreve e vendimeve tjera do të suspendohen nga Shoqata varësisht prej rezultateve të hetimeve për sjellje joprofesionale.
- 4.17 Këshilli mundet kohë pas kohe t'i modifikojë, definojë apo ri-definojë kërkesat për anëtarësim në Shoqatë apo të themeloj komision për shqyrtimin e kritereve për anëtarësim dhe t'i bëj rekomandime Asamblesë.

Pjesa 5 Struktura organizative e Shoqatës

Asambleja e Anëtarëve

- 5.1 Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqatës i përbërë nga të gjithë anëtarët që i plotësojnë kushtet për anëtarësim.
Asambleja përbehet nga të gjithë anëtarët që janë kontabilistë të certifikuar dhe auditorë të certifikuar të SHKÇAK të cilët gëzojnë reputacion të mirë.

Të drejtat dhe Përgjegjësitë

- 5.2 Asambleja do të:
- (i) aprovojë raportin vjetor të SHKÇAK përfshirë edhe pasqyrat e audituara financiare;
 - (ii) aprovojë buxhetin e ShKÇAK;
 - (iii) aprovojë amendamentet në Statutin e SHKÇAK;
 - (iv) aprovojë strategjinë e përgjithshme dhe propozimet e politikave të Këshillit të SHKÇAK;
 - (v) zgjedh anëtarët e Këshillit të SHKÇAK;
 - (vi) aprovojë rekomandimet e Këshillit mbi ndryshimet e tarifës vjetore për anëtarësi për anëtarët e SHKÇAK;
 - (vii) zgjedh auditorin për auditimin e pasqyrave financiare të ShKÇAK;
 - (viii) zgjedh anëtarët e Komisionit Disiplinor.
 - (ix) zgjedh anëtarët e Komisionit për Nominime

Mbledhjet e Përgjithshme

- 5.3 Asambleja mbledhet aq herë sa kërkohet nga ligji i aplikueshëm. Mbledhja e Përgjithshme Shoqatës do të mbahet deri më 30 Qershor të vitit përveç kur përcaktohet ndryshe nga Këshilli.
- 5.4 Kryetari i Shoqatës do t'i njoftojë anëtarët për datën, vendin dhe kohën e Mbledhjes së Përgjithshme rregullt së paku 30 ditë para ditës së takimit
- 5.5 Në mbledhjet e rregullta Asambleja do të vendosë në lidhje me çështjet e caktuara në nenin 5.2 të këtij Statuti.
- 5.6 Të gjitha çështjet tjera që nuk janë të caktuara në nenin 5.2 këtij Statuti do të konsiderohen çështje të veçanta.

Mbledhjet e Jashtëzakonshme

- 5.7 Kryetari i Shoqatës do ta thërras Mbledhjen e Jashtëzakonshme nëse këtë e kërkojnë një e treta e anëtarëve të Shoqatës, apo dy të tretat e anëtarëve të Këshillit.
- 5.8 Mbledhja e Jashtëzakonshme do të thirret brenda 60 ditëve nga pranimi i kërkesës.
- 5.9 Kryetari i Shoqatës do t'i njoftojë anëtarët mbi rendin e ditës, datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes së Jashtëzakonshme së paku 14 ditë (pa e llogaritur ditën e dërgimit dhe ditën e mbajtjes së mbledhjes) para mbledhjes.
- 5.10 Poqese Kryetari i Shoqatës nuk e mban mbledhjen e jashtëzakonshme brenda 60 ditëve nga data e pranimit të kërkesës, kërkuesit e cekur në nenin 5.7 mund ta thërrasin mbledhjen e Asamblesë në mënyrë të pavarur.
- 5.11 Në rast se kërkuesit e një Mbledhje të Jashtëzakonshme janë të detyruar ta thërrasin Asamblenë, Zyra Ekzekutive do t'i marrë përsipër të gjitha funksionet e Kryetarit të Shoqatës për thirrjen e mbledhjes në përputhje me nenin 5.10.

Rendi i ditës dhe çështje të posaçme

- 5.12 Së paku 30 (tridhjetë) ditë para mbajtjes së Mbledhjes së Përgjithshme, anëtarët do të marrin:
 - (i) njoftimin mbi kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së Mbledhjes;
 - (ii) rendin e ditës të detajuar të çështjeve që do të diskutohen në Mbledhje;
 - (iii) fletëvotimet dhe fletëvotimet e autorizuar në rast se anëtari nuk mund të marrë pjesë.
- 5.13 Anëtarët do të mund të propozojnë çështje për tu përfshirë në rendin e ditës si çështje të posaçme, të paraqesin komente apo ndryshime të tij të cilat do të pranohen nga Zyra Ekzekutive më së largu 15 ditë para mbajtjes së Mbledhjes. Propozimet për përfshirje në rendin e ditës, komentet dhe ndryshimet e pranuar më vonë se 15 ditë nuk do të përfshihen në diskutime nga Asambleja në ditën e Mbledhjes së Përgjithshme si çështje të posaçme.

Procedura e votimit dhe kuorumi

- 5.14 Kuorumi në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë do të arrihet me shumicën e thjeshtë (51%) të anëtarëve të Shoqatës .
- 5.15 Kur nuk arrihet kuorumi, Kryetari i Shoqatës, shpall Mbledhjen e Jashtëzakonshme. dhe rendi i ditës mbetet i njëjtë me mbledhjen në të cilën nuk është arritur kuorumi.
- 5.16 Kur Mbledhja e Jashtëzakonshme mbahet në vend të Mbledhjes së Përgjithshme, kuorumi arrihet me një të katërtën (25%) e anëtarëve prezent.
- 5.17 Kryetari i Këshillit do të kryesoj Mbledhjen e Përgjithshme apo atë të Jashtëzakonshme, kurse në mungesë të tij do të kryesojë Nënkryetari.
- 5.18 Në ditën e mbledhjes, kryesuesi do ta emërojë komisionin ad-hoc zgjedhor me detyrë për t'i numëruar votat me ngritje të dorës dhe ato me fletëvotime.
- 5.19 Kandidatët e nominuar për zgjedhje në Asamble nuk mund të jenë anëtar të komisionit zgjedhor i cili do të numërojë votat.

Votimi

- 5.20 Vendimet, përveç ndryshimeve apo amendamenteve në Statut dhe shpërbërjes së Shoqatës, që do të merren në Mbledhjen e Përgjithshme apo të Jashtëzakonshme do të aprovohen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezent, përpos nëse kërkohet ndryshe nga ky Statut.
- 5.21 Asambleja do të vendosë me dy të tretat e votave të anëtarëve për miratimin apo ndryshimin e Statutit, ose për shpërbërjen e Shoqatës;
- 5.22 Një anëtar mund të votojë me fletëvotim të autorizuar. Fletëvotimi i autorizuar duhet t'i dorëzohet Drejtorit Ekzekutiv së paku shtatë ditë kalendrike para Asamblesë. Fletëvotimi i autorizuar i arritur më vonë se shtatë ditë kalendrike para mbajtjes së mbledhjes së përgjithshme apo të jashtëzakonshme nuk do të merret në konsiderim dhe anëtari do të njoftohet për këtë.
- 5.23 Drejtori Ekzekutiv do ta pranojë si të vlefshëm fletëvotimin e autorizuar kur vërtetësia e tij është jashtë çdo dyshimi.
- 5.24 Anëtarët do të kenë edhe mundësinë të votojnë përmes votimit elektronik kurse Këshilli do të zhvilloj rregulla që do ta lehtësojnë votimin elektronik.

Këshilli

- 5.25 Këshilli është organ i caktuar nga Asambleja që në emër të saj (Asamblesë) të mbikëqyrë qeverisjen e SHKÇAK.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- 5.26 Këshilli, në kuadër të detyrave të veta, do të ketë edhe këto të drejta dhe përgjegjësi specifike:
- (i) i propozon në Asamblesë amendamentet dhe ndryshimet e Statutit të Shoqatës;
 - (ii) nxjerr Udhëzime Administrative, rregullore dhe vendime, duke përfshirë por pa u kufizuar në implementimin e DOA të FNK, për fushëveprimin e Shoqatës dhe Komisioneve;
 - (iii) interpreton Statutin e SHKÇAK;
 - (iv) i propozon Asamblesë çfarëdo ndryshimi në strukturën e tarifës për anëtarësi vjetore;
 - (v) paraqet raportin vjetor duke përfshirë edhe pasqyrat financiare të audituara para Asamblesë;
 - (vi) zgjedh Kryetarin, nënkryetarin e SHKÇAK dhe arkëtarin e ShKÇAK nga radhët e veta;
 - (vii) themelon numër të nevojshëm të komisioneve në fushat e specializuara të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit dhe të cilat do të këshillojnë, udhëzojnë dhe implementojnë Qëllimet, Objektivat dhe Aktivitetet e ShKÇAK.
 - (viii) zgjedh Drejtorin Ekzekutiv të Shoqatës.

Përbërja

- 5.27 Këshilli do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtar.
- 5.28 Çdo anëtar mund të jetë i përshtatshëm për tu zgjedhur (përfshirë rizgjedhjen) si anëtar i Këshillit nëse në datën e nominimit për zgjedhje apo njoftimit me shkrim për ri-zgjedhje, anëtari i plotëson kushtet për zgjedhje apo ri-zgjedhje bazuar në kriteret e anëtarësisë së SHKÇAK.
- 5.29 Anëtari mund të nominohet nga tre apo më shumë anëtarë të Shoqatës. Çdo nominim duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga secili anëtar që e ka bërë nominimin.
- 5.30 Anëtari i Këshillit i cili synon rizgjedhjen gjithashtu duhet të nominohen nga së paku tre apo më shumë anëtarë dhe duhet ta njoftojë me shkrim Këshillin për synimin e tij për rizgjedhje.
- 5.31 Çdo kandidat i cili synon zgjedhjen apo rizgjedhjen do ta nënshkruajë deklaratën me të cilën e konfirmon vullnetin e tij të jetë anëtar i Këshillit dhe se kandidati do të pajtohet me Kodin Profesional të Mirësjelljes të Shoqatës dhe FNK dhe udhëzimet administrative, vendimet dhe rregulloret të adoptuara nga Këshilli.
- 5.32 Anëtarët e Këshillit, përfshirë Kryetarin dhe Nënkryetarin, duhet të kenë përvojë profesionale aktuale në sektorin publik apo privat të kontabilitetit, auditimit, bankave, financave, sigurimeve apo sektori tjetër të tregtisë.

- 5.33 Këshilli do të udhëhiqet nga Kryetari i Shoqatës.
- 5.34 Anëtarët e Këshillit do të zgjedhen vetëm për mandatin e lejuar.
- 5.35 Anëtari i cili ka shërbyer si anëtar i Këshillit në mandatin e lejuar do të mund të kandidohet sërish pas kalimit të afatit të dyvjeçar pas përfundimit të mandatit të lejuar në qoftë se i plotëson kriteret për tu zgjedhur si anëtar i Këshillit.
- 5.36 Këshilli mund të shkarkojë nga detyra anëtarin e Këshillit para përfundimit të mandatit me dy të tretat e votave të Këshillit të plotë(pesë vota pozitive).
- 5.37 Kur një anëtar i Këshillit jep dorëheqje, largohet apo vdes, ai/ajo do të zëvendësohet për mandatin e mbetur si anëtar i Këshillit nga anëtari i cili në takimin e fundit të Asamblesë ka qenë i nominuar për anëtar të Këshillit por numri i votave valide me emrin e tij e ka vendosur atë në vendin e parë të listës së të nominuarve që nuk janë zgjedhur. Pasi të bëhet anëtar i Këshillit anëtari do t'i gëzojë të gjitha të drejtat përfshirë të drejtën e votimit si anëtar i Këshillit.
- 5.38 Të nominuarit nga pozita e parë dhe e dytë e të pazgjedhurve për Këshill do të mund të marrin pjesë në takimet e Këshillit gjatë mandatit të Këshillit si anëtarë të Këshillit pa të drejtë vote.

Kriteret skualifikuese

- 5.39 Asnjë person nuk do të zgjedhet si anëtar i Këshillit, e poashtu dhe anëtarët e Këshillit të zgjedhur me herët do të largohen, për shkaqe si vijojnë:
- (i) shturja e kapaciteteve të përgjithshme për të ndërmarrë transaksione ligjore
 - (ii) dënimit për veprë për të cilën është shqiptuar dënimi me burgim
 - (iii) administrim ligjor, bankrotim apo likuidim i padashur nga gjyqi apo autoriteti kompetent e cilëso firmë të poseduar apo kontrolluar, direkt apo indirekt, nga ky person apo anëtarë.
 - (iv) të qenit në lidhje gjaku apo fisnore deri në shkallën e dytë me cilindo anëtar të Këshillit apo me cilindo punëtor të Shoqatës.
 - (v) mungesa pa ndonjë arsye të mirëfilltë, në tri apo me tepër mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit.
 - (vi) duke rrezikuar materialisht interesat e Shoqatës përmes punës dhe të veprimeve të kryera
 - (vii) duke mos ia shpalosur Këshillit interesat direkte apo indirekte biznesore, veprim që mund të interpretohet si komprometim i pavarësisë së anëtarit.
- 5.40 Një anëtar i Këshillit i cili për çfarëdo arsye nuk mund të marrë pjesë në punën e Këshillit në një periudhë më të gjatë se një e katërta e mandatit të Këshillit (dmth gjashtë muaj) automatikisht do të largohet nga pozita e tij në Këshill dhe në vend të tij do të caktohet anëtari i Këshillit në pajtueshmëri me Nenin 5.38.

Kryetari dhe Nënkryetari

- 5.41 Kryetari dhe Nënkryetari zgjedhen nga Këshilli
- 5.42 Kryetari ka mandate dyvjeçar

- 5.41 Mandati i Nënkryetarit është dyvjeçar pa të drejtë të rizgjedhjes në të njëjtën pozitë. Pas përfundimit të mandatit të tij, Nënkryetari do të bëhet Kryetar me mandat dyvjeçar në këtë pozitë.
- 5.42 Në rast se Nënkryetari pas përfundimit të mandatit të tij nuk do të bëhet Kryetar, Këshilli do të:
- (i) emërojë kandidatin e zgjedhur për Nënkryetar të shërbejë si Kryetar dhe i cili do të shërbejë për periudhë dyvjeçare, dhe
 - (ii) zgjedh nga radhët e Anëtarëve të Këshillit kandidatin i cili do të shërbejë si Nënkryetar për mandatin e Kryetarit të emëruar në pajtim me nenin 5.44 (i),
- 5.43 Në rast se Kryetari në detyrë nuk do të mund ta përfundojë mandatin e tij, Këshilli do të:
- (i) emërojë Nënkryetarin që do të shërbejë si Kryetar për mandatin e mbetur dhe pas përfundimit të kësaj periudhe Nënkryetari i emëruar do të vazhdojë të shërbejë si Kryetar për periudhë dyvjeçare, dhe
 - (ii) zgjedh nga radhët e Anëtarëve të Këshillit kandidatin që do të shërbejë si Nënkryetar për mandatin e Kryetarit të emëruar në pajtim me nenin 5.45 (i).
- 5.46 Kryetari ka këto kompetenca specifike:
- (i) thërret dhe udhëheq mbledhjet e Asamblesë;
 - (ii) udhëheq mbledhjet e Këshillit;
 - (iii) përfaqëson Shoqatën së bashku me Drejtorin Ekzekutiv në vend dhe jashtë vendit;
 - (iv) i dorëzon raportin vjetor Asamblesë.
 - (v) i merr përsipër të gjitha detyrat e tjera për përmbushjen e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve të Shoqatës.

Arkëtari

- 5.47 Arkëtari i SHKÇAK është i zgjedhur nga Këshilli me mandat dyvjeçar dhe mund të rizgjedhet nga Këshilli për mandatin e dytë . Arkëtari ka përgjegjësitë si vijon:
- (i) Rishikon buxhetin vjetor dhe pasqyrat financiare të përgatitura nga Zyra Ekzekutive dhe ofron raportin gjysmëvjetor të menaxhimit në Këshill mbi çështjet financiare të SHKÇAK;
 - (ii) Bashkëpunon me Zyren Ekzekutive të SHKÇAK dhe me auditorët e caktuar për të ndihmuar kryerjen në kohë të auditimit vjetor të pasqyrave financiare të Shoqatës dhe implementimin e rekomandimeve të dhëna pas kryerjes së auditimit.

Mbledhjet

- 5.48 Këshilli do të takohet së paku katër herë në vit. Mbledhjet e Këshillit do të thirren nga Kryetari i Shoqatës.
- 5.49 Anëtarët e Këshillit do të njoftohen së paku pesë ditë para datës së mbledhjes së bashku me rendin e ditës, kohën dhe vendin e mbledhjes. Këshilli do të vendos për të gjitha çështjet siç është cekur në nenin 5.26 të këtij Statuti si dhe për çështjet tjera për mbështetjen e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve.

- 5.50 Drejtori Ekzekutiv apo personi i nominuar nga Zyra Ekzekutive do të veproj si sekretar i mbledhjeve të Këshillit, do ta mbaj procesverbalin e çdo mbledhje të Këshillit dhe do t'ua shpërndaj anëtarëve të Këshillit për aprovim.
- 5.51 Anëtari i Këshillit nuk do të marr pjesë në shqyrtimin e vendimeve për çfarëdo çështje në të cilat ka interes personal direkt apo indirekt apo interes ekonomik. Do të konsiderohet se anëtari i Këshillit ka interes ekonomik në rast se ai ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik lidhur me çështjet që shqyrtohen nga Këshilli.

Votimi në Mbledhjet e Këshillit

- 5.52 Këshilli do të vendosë për të gjitha çështjet me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve përpos nëse ceket ndryshe në Statut.
- 5.53 Në rast të votave të barabarta, Kryetari ka votën vendimtare.

Komisionet e Këshillit

- 5.54 Përbërja e secilit komision do të përcaktohet nga Këshilli. Anëtarët e komisioneve do të caktohen në rast se i përmbushin kërkesat e ftesës për nominime të publikuara nga Komisioni për Nominime për komisionin përkatës.
- 5.55 Këshilli mundet sipas kërkesës së kryetarit të komisionit të inkuadroj në komisione persona të cilët nuk janë anëtarë të SHKÇAK por të cilët posedojnë kualifikim dhe përvojë e cila kërkohet për realizimin efektiv të detyrave të komisionit. Anëtarët e SHKÇAK gjithmonë do të përbëjnë shumicën në komisione.
- 5.56 Përshkrimi i kërkesave për anëtarët e jashtëm të komisioneve do të përcaktohen nga kryetari i komisionit në konsultim me Komisionin për Nominime i cili do të publikojë ftesën për nominime.
- 5.57 Këshilli do të përshkruajë me rregullore apo urdhër tjetër administrativ rregullimin dhe kuorumin e çdo komisioni të themeluar dhe mund të përshkruajë procedurat që duhet të ndiqen nga çdo komision.
- 5.58 Këshilli mund ta shpërndaj çdo komision në tërësi apo një pjesë të tij.

Kompensimi i anëtarëve të Këshillit

- 5.59 Anëtarët e këshillit do të kompensohen për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit në bazë të rregullave të përcaktuara nga Këshilli me vendim të posaçëm dhe në pajtueshmëri me dispozitat relevante të ligjit të aplikueshëm.

Zyra Ekzekutive

- 5.60 Drejtori Ekzekutiv do të jetë Kryeshef Ekzekutiv i Shoqatës i zgjedhur nga Këshilli.
- 5.61 Drejtori Ekzekutiv do t'i raportojë Kryetarit dhe Këshillit.

Detyrat dhe përgjegjësitë

5.62 Drejtori Ekzekutiv në kuadër të detyrave të veta i ka edhe këto përgjegjësi specifike:

- (i) të punojë me Këshillin në zhvillimin dhe implementimin e biznes planit strategjik afatgjatë si dhe planit vjetor të Shoqatës;
- (ii) të ndërtojë kapacitete organizative të Shoqatës siç përcaktohet nga Këshilli.
- (iii) të mbikëqyrë personelin e Zyrës Ekzekutive;
- (iv) të organizojë programet trajnuese të Shoqatës;
- (i) të mbajë dhe zhvillojë marrëdhëniet me donatorët ekzistues dhe të mundshëm;
- (ii) të punojë me media që të sigurojë mbulimin e duhur të aktiviteteve të Shoqatës nëpër media;
- (iii) të këshillojë, adoptojë dhe implementojë politikat e veprimit dhe aktivitetet e Shoqatës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave.
- (iv) të implementojë udhëzimet administrative, vendimet, rregulloret dhe instrumentet tjera të adoptuara nga Asamblea dhe Këshilli.
- (v) të implementoj buxhetin e Shoqatës.
- (vi) të ndërmarr të gjitha aktivitetet për t'i mbështetur në vazhdimësi Qëllimet dhe Objektivat e Shoqatës.

5.63 Struktura e Zyrës Ekzekutive do të definohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe do të aprovet nga Këshilli.

5.64 Të punësuarit e Shoqatës, duke përfshirë këtu edhe Drejtorin Ekzekutiv, nuk mund të zgjedhen si anëtarë të Këshillit.

5.65 Asnjë person nuk do të zgjedhet si Drejtor Ekzekutiv, si dhe Drejtori Ekzekutiv i zgjedhur më herët do të largohet nga detyra për këto arsye:

- (i) shthurja e kapaciteteve të përgjithshme për të ndërmarrë transaksione ligjore;
- (ii) dënimit për vepër për të cilën është shqiptuar dënimi me burgim;
- (iii) administrim ligjor, bankrotim apo likuidim i padashur nga gjyqi apo autoriteti kompetent e cilësdo firmë të poseduar apo kontrolluar, direkt apo indirekt, nga ky person apo anëtar;
- (iv) të qenit në lidhje gjaku apo fisnore deri në shkallën e dytë me cilindo anëtar të Këshillit apo me cilindo punëtor të Shoqatës;

duke rrezikuar materialisht interesat e Shoqatës nëpërmes të punës dhe të veprimeve të kryera.

- 5.66 Asnjë individ që ka lidhje gjaku apo fisnore deri në shkallën e dytë me Drejtorin Ekzekutiv, nuk mund të ketë interes personal direkt apo indirekt në cilindo nga veprimet e Shoqatës.
- 5.67 Drejtori Ekzekutiv, me rastin e marrjes së detyrës, si dhe në secilin vit që pason, është i obliguar që të informojë Këshillin për çdo lloj interesi personal direkt apo indirekt, me të cilin ai apo anëtarët e familjes së tij kanë lidhje me veprimet e Shoqatës.

Komisioni për nominime

- 5.68 Asambleja do ta themelojë Komisionin për nominime dhe do të zgjedh anëtarët e tij. Komisioni për Nominime do të përbëhet nga 7 anëtarë:
- (i) Kryetari aktual i Këshillit,
 - (ii) Dy ish Kryetar të Këshillit,
 - (iii) Katër ish anëtarë të Këshillit
- 5.69 Drejtori Ekzekutiv apo i deleguari i tij do të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit por pa të drejtë vote.
- 5.70 Komisioni për Nominime do ta këshilloj dhe do ti jap rekomandime Këshillit për:
- (i) Nominimin e anëtarëve për Këshill,
 - (ii) Nominimin e anëtarëve për komisionet e themeluara nga Këshilli dhe Asambleja,
- 5.71 Anëtarët e Komisionit për Nominime do të zgjedhen për mandat 4 vjeçar me të drejtë të rizgjedhjes nga Asambleja.

Pjesa 6 Procedura Disiplinore

Procesi Disiplinor

- 6.1 Anëtari do të nënshtrohet procesit disiplinor, në rast se:
- (i) gjatë ushtrimit të aktiviteteve profesionale bën shkelje të rregullave të mirësjelljes;
 - (ii) gjatë ushtrimit të profesionit e ka sjell veten apo profesionin në pozitë joadekuate, joefektive ose të papërgjegjshme;
 - (iii) ka shkelur Statutin, udhëzimet administrative, vendimet apo rregulloret tjera të cilat ka deklaruar se do t'i respektoj; ose
 - (iv) i janë shqiptuar masa disiplinore nga ndonjë trup tjetër profesional apo në lidhje me ndonjë proces tjetër disiplinor.

Përbërja e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë

- 6.2 Asambleja do ta themeloj Komisionin për Sjellje dhe Disiplinë të përbërë nga pesë (5) anëtarë dhe do t'i zgjedh anëtarët e këtij Komisioni.
- 6.3 Kur një anëtar i komisionit jep dorëheqje, largohet apo vdes, ai/ajo do të zëvendësohet për mandatin e mbetur si anëtar i Komisionit nga anëtari i cili në takimin e fundit të Asamblesë ka qenë i nominuar për anëtar të Komisionit por numri i votave valide me emrin e tij e ka vendosur atë në vendin e parë të listës së të nominuarve që nuk janë zgjedhur.
- 6.4 Anëtarët e komisionit disiplinor do të zgjedhen nga Asambleja me mandat trevjeçar duke u bazuar në rekomandimet e Këshillit. Anëtarët e Këshillit nuk mund të zgjedhen anëtar të komisionit disiplinor.
- 6.5 Procedura Disiplinore do të zhvillohet në pajtueshmëri me këtë Statut dhe udhëzimet administrative, vendimet, rregulloret dhe Rregullat e Mirësjelljes Profesionale ashtu si janë adoptuar nga Shoqata.
- 6.6 Procedura disiplinore ndaj anëtarit mund të mbahet pas pranimit të ankesës nga anëtarët e Këshillit, palët e treta duke përfshirë çdo anëtar të Shoqatës.
- 6.7 Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë do të hulumtojë secilin rast në veçanti në pajtueshmëri me rregulloret e aprovuara nga Këshilli dhe dispozitat e Ligjit të Aplikueshëm në mënyrë që të përcaktojë gjendjen faktike. Komisioni disiplinor mund t'i shqiptojë këto masa si të vetme apo në kombinim me njëra tjetrën:
- (i) vërejtje, ose
 - (ii) suspendim, ose
 - (iii) largim.

E drejta në Ankesë

- 6.8 Anëtarët do ta kenë të drejtën e ankesës ndaj vendimit të Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë në përputhje me dispozitat e ligjit të aplikueshëm.
- 6.9 Me pranimin e ankesës Kryetari i Shoqatës do ta themeloj një panel të përbërë nga tre anëtar të Këshillit duke përfshirë Kryetarin dhe Nënkryetarin e Këshillit. Drejtori Ekzekutiv apo zyrtari i deleguar nga ai do të marrë pjesë në takimet e panelit por pa të drejtë vote.
- 6.10 Anëtarët e Këshillit të caktuar në Panelin për Ankesa do ta nënshkruajnë deklaratën përmes së cilës konfirmojnë se:
- (i) nuk kanë asnjë interes ekonomik direkt apo indirekt
 - (ii) nuk janë në lidhje gjaku apo fisnore deri në shkallën e dyte me ankuesin.
- 6.11 Në rast se anëtarët e Panelit për Ankesa janë diskualifikuar nga mundësia për të qenë anëtarë të Panelit do të tërhiqen kurse Kryetari i Shoqatës do t'i nominoj anëtarët e tjerë të Këshillit për anëtar të Panelit.
- 6.12 Deri në vendimin përfundimtar lidhur me ankesën, anëtari do të mbetet i larguar nga anëtarësia e Shoqatës.

Pjesa 7

Rregullat e Mirësjelljes Profesionale

- 7.1 Versioni në gjuhën angleze i Rregullave të Mirësjelljes Profesionale do të mbizotëroj në çdo rast të konfliktit në interpretim të Kodit Etik të FNK në njërën anë dhe çdo dokumenti të përkthyer nga SHKÇAK apo rregullore tjera dhe udhëzime administrative të lëshuara nga SHKÇAK në anën tjetër.

Pjesa 8

Pasuritë

- 8.1 Pasuritë e Shoqatës përbëhen nga parat e gatshme, prona e tundshme, pasuritë e patundshme si dhe e drejta mbi pronën të cilën Shoqata e ka fituar duke u bazuar në ligjin e aplikueshëm dhe në këtë Statut.

Shoqata siguron të ardhurat nga:

- pagesat e anëtarësimit;
- donacionet; dhe
- aktivitetet e tjera ekonomike që shoqata mund t'i kryejë në pajtueshmëri me këtë Statut dhe ligjin e aplikueshëm.

- 8.2 Asambleja do t'ia delegojë Këshillit përgjegjësinë për menaxhimin e pasurive të Shoqatës në pajtueshmëri me Qëllimet, Objektivat dhe Aktivitetet e Shoqatës dhe do të kërkojë nga Kryetari i Këshillit të dorëzojë një raport vjetor për menaxhimin me këto pasuri gjatë vitit raportues.

Pjesa 9

Shpërbërja e Shoqatës dhe shpërndarja e pronës

- 9.1 Shoqata do të shpërbëhet me vendim të përkrahur nga dy të tretat e votave të Asamblesë.
- 9.2 Me shpërbërjen e saj, Asambleja do të caktojë emrin e organizatës dhe/apo shoqatës e cila do t'i marrë pasuritë e mbetura të Shoqatës pasi që të jenë paguar borxhet, shpenzimet e gjyqit dhe/apo shpenzimet e tjera procedurale.

Pjesa 10

Hyrja në fuqi

- 10.1 Ky Statut hyn në fuqi në ditën a aprovimit nga Asambleja

Prishtinë, 28 qershor 2010

Nazmi Pllana
Kryetar i SHKÇAK